

**OVLUÇK-ja mbështet
protestën e 12 shtatorit në
mbështetje të ish-krerëve
të UÇK-së** I FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

'MË 16 SHTATOR PRESIM FITOREN E DYTË TË KOSOVËS', QYTETARËT PRESIN LIRIMIN E ISH-KRERËVE TË UÇK-së

 I FAQE 4-5

Në prag të vendimit përfundimtar në Hagë, qytetarët presin lirin e ish-krerëve të UÇK-së dhe e cilësojnë 16 shtatorin si një ditë vendimtare për Kosovën. Ndërkaq, platforma qytetare

"Liria ka Emër" ka vendosur në Prishtinë të ashtuquajturën "Ora e Pritjes", një ekran gjigant që do të numërojë ditët, orët, minutat dhe sekondat deri më 16 shtator, në shenjë pritjeje dhe

mbështetjeje për ish-krerët e UÇK-së. Në qytete të ndryshme të Kosovës ka nisur gjithashtu vendosja e banerëve me mesazhin "Kosova po pret", si dhe e flamujve me logon e UÇK-së

**BARALIU:
MOSTHIRRJA
E SEANCËS MUND TË
JETË PËR SHTYRJEN
E AFATEVE DHE
ZGJEDHJET
E MUNDSHME** F. 3



**PKD DHE
ALEANCA
AKUZOJNË
KURTIN PËR
BLOKIM
TË INSTITU-
CIONEVE** F. 5



AKTUALE
NDAHET NGA JETA EQREM KRYEZIU F. 7



**HEGSETH: SHBA-ja S'E PËRJASHTON
PËRDORIMIN E FORCËS USHTARAKE
KUNDËR IRANIT** F. 2

**DIOGUARDI DHE POWLES
NË BIBLIOTEKËN KOMBËTARE,
VLERËSOHET KONTRIBUTI
I TYRE PËR KOSOVËN** F. 6

EKONOMI



**KOSOVA E VARUR NGA MISHI
BRAZILIAN, NDËRSA BE-ja
VENDOS KUFIZIME** F. 8

**"PUNËTORËT NUK JANË NUMRA,
JANË JETË", SINDIKATA E RE E
KEK-ut ME AKSION SIMBOLIK
PARA ZYRAVE TË KEK-ut** F. 8

SPORT



**DONJETA SADIKU SIGURON
MEDALJEN E PARË PËR
KOSOVËN NË "TARANTO 2026"** F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVIÇE
044/256-051
044/367-061
028/532-617

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

HEGSETH: SHBA-ja S'E PËRJASHTON PËRDORIMIN E FORCËS USHTARAKE KUNDËR IRANIT

UASHINGTON, 25 GUSHT - Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Pete Hegseth, tha se Shtetet e Bashkuara nuk e përjashtojnë përdorimin e forcës ushtarake kundër Iranit. Deklarata e tij vjen pasi Uashingtoni vendosi sanksione të reja kundër gati 60 subjekteve, individëve dhe anijeve, në kuadër të përpjekjeve për të shtuar presionin ekonomik ndaj Teheranit. “Në asnjë mënyrë nuk e përjashtojmë mundësinë e sulmeve ushtarake në Ngushticën e Hormuzit apo rreth Iranit”, u tha Hegseth gazetarëve më 24 gusht. Ai shtoi se Irani nuk do të jetë në gjendje t'i përballojë presionet ekonomike që po ushtrohen ndaj tij.

Ngushtica e Hormuzit

Rreth 20 për qind e sasisë së përgjithshme të naftës së lëngshme që shfrytëzohet nëpër botë qarkullon përmes Ngushticës së Hormuzit, një grykë kritike ndërmjet Omanit dhe Iranit. Transporti përmes ngushticës ka rënë në mënyrë drastike për shkak të konfliktit në rajon. Në fillim të këtij muaji, Hegseth tha se forcat amerikane mund ta mbajnë për një kohë të pacaktuar bllokadën detare ndaj Iranit dhe se Uashingtoni mund t'i ndërrojë anijet ushtarake në rajon sipas nevojës. Departamenti amerikan i Thesarit shpalli më 24 gusht një fushatë të re dhe të gjerë presioni ekonomik ndaj Iranit, të cilën e quajti “Dita D ekonomike”. Uashingtoni paralajmëroi, gjithashtu, se vendet që vazhdojnë ta mbështesin Teheranin, rrezikojnë të izoloohen ndërkombëtarisht.

Sipas zyrtarëve amerikanë, qëllimi është t'i ndërpriten Qeverisë iraniane burimet e financimit dhe të rritet më tej izolimi ndërkombëtar i Iranit. “Synimi ynë është të ndërpresim çdo burim ekonomik që mban në këmbë këtë regjim tiranik, derisa Teherani të mbetet i vetëm”, tha sekretari amerikan i Thesarit, Scott Bessent. Lufta e SHBA-së dhe Izraelit me Iranin nisi më 28 shkurt 2026, kur forcat amerikane dhe izraelite sulmuan Republikën Islamike, me synimin e deklaruar për të goditur programin e saj bërthamor dhe kapacitetet raketore. Irani u kundërpërgjigj me sulme me raketa dhe dronë ndaj Izraelit dhe objektivave amerikane në rajon, ndërsa kufizoi ndjeshëm edhe trafikun përmes Ngushticës së Hormuzit - një nga rrugët më të rëndësishme në botë për transportin e naftës dhe gazit. Konflikti, që po zgjat prej gati gjashtë muajsh, ka shkaktuar ndërprerje të mëdha në furnizimet globale me energji.

Valuta iraniane bie ndjeshëm, teksa Uashingtoni përgatit sanksione të ashpra

Ekonomia tashmë e goditur e Iranit po shfaq sërish shenja tendosjeje derisa Uashingtoni po përgatitet të shpallë sanksione që zyrtarët amerikanë i kanë përshkruar si disa nga më të ashpra të vendosura ndonjëherë ndaj Teheranit. Valuta iraniane ra në një nivel të ri rekord më 24 gusht, me dollarin që në tregun e hapur arriti në 2.016.400 rialë. Sekretari amerikan i Thesarit, Scott Bessent, paralajmëroi se



Uashingtoni po përgatit një “Ditën D ekonomike” për Iranin, me sanksione më të ashpra dhe masa të mundshme dytësore ndaj vendeve dhe kompanive që vazhdojnë të bëjnë biznes me Teheranin. Ahmad Alavi, profesor iranian i ekonomisë në Suedi, thotë se luhatjet e fundit po nxiten jo vetëm nga problemet strukturore të kahershme të vendit, por edhe nga pritshmëritë për atë që mund të sjellin sanksionet më të ashpra. Ekonomia e Iranit tashmë vuan nga politikat joefektive, qeverisja e dobët, sanksionet dhe një mjedis luftime, tha Alavi për Radion Farda të Radios Evropa e Lirë (REL). Por, megjë këto kushte themelore nuk kanë ndryshuar në mënyrë dramatike ditët e fundit, ai beson se psikologjia e tregut po luan një rol gjithnjë e më të rëndësishëm. “Rritja e kursit të këmbimit e intensifikon inflacionin, ndërsa

inflacioni i pritshëm dhe ai real bëjnë që kursi i këmbimit të rritet përsëri. Ky rreth vicioz, si të thuash, po vazhdon”, tha Alavi. Duke pasur parasysh ekonominë e luftës dhe kufizimet strukturore të Iranit, ai shtoi se “duket se kjo do të vazhdojë”. Alavi ishte gjithashtu skeptik se rritja e eksporteve jashtë naftës mund të ofrojë një zgjidhje të shpejtë, duke pasur parasysh izolimin bankar të Iranit dhe varësinë nga ndërmjetësit për riatdhesimin e të ardhurave nga eksportet. Por, jo të gjithë janë të bindur se forcimi i sanksioneve do ta ketë ndikimin e dëshiruar. Analisti politik me bazë në Shtetet e Bashkuara, Ebrahim Roshandel, tha për Radion Farda se sanksionet mund të mos i dobësojnë domosdo forcat që kundërshtojnë negociatat me Uashingtonin. Ai argumenton se sanksionet e kanë tkurrur ekonominë formale të Iranit,

ndërsa kanë rritur fuqinë relative të rrjeteve jo transparente, rezistente ndaj sanksioneve dhe të lidhura me institucione të fuqishme. Ai shtoi se presidenti Masud Pezeshkian ka pak autoritet real, duke e përshkruar qeverinë si të kufizuar nga qendrat paralele dhe të pazgjedhura të pushtetit. “Qeveria, si përfaqësuese e popullit, dhe Pezeshkiani në krye të saj, nuk ka asnjë mjet në dispozicion”, tha ai, duke e cilësuar atë si “thjesht një qeveri burokratike”, të lënë mënjanë nga Korpusi i Gardës Revolucionare Islamike (IRGC) dhe entitete të tjera të fuqishme që i përgjigjen vetëm liderit suprem. “Sanksionet nuk i kanë ndëshkuar kundërshtarët e një marrëveshjeje, por i kanë financuar ata”, tha ai, duke argumentuar se çdo muaj vonesë rrit pjesën e IRGC-së në ekonomi dhe fuqinë e saj në vendimmarrje.

NXEHEN OQEANET. TEMPERATURA MESATARE ARRIN 21,1 GRADË, NIVELI MË I LARTË I REGJISTRUAR

BRUKSEL, 25 GUSHT - Oqeanet e botës kanë shënuar temperaturën mesatare më të lartë që nga fillimi i matjeve në vitin 1979. Sipas të dhënave të programit të Bashkimit Europian, Copernicus, më 22 gusht temperatura mesatare globale e sipërfaqes së deteve dhe oqeanëve arriti në 21,1 gradë Celsius. Rekordi i ri vjen në një periudhë të pazakontë të vitit. Zakonisht, temperaturat mesatare të oqeanëve arrijnë nivelet më të larta në muajt mars dhe prill, pas verës në hemisferën jugore. Rekordi i mëparshëm, prej 21,09 gradësh Celsius, ishte regjistruar në mars të vitit 2024.



Sipas klimatologut Stefan Rahmstorf, nga Instituti i Potsdamit për Kërkimin e

Ndikimeve Klimatike, rekordi i ri është kryesisht pasojë e ngrohjes globale të shkaktuar

nga emetimet e gazeve serrë, veçanërisht nga djegia e naftës, gazit natyror dhe qymyrit. Një tjetër faktor është fenomeni klimatik El Nino, i cili shfaqet periodikisht në Oqeanin Paqësor dhe sjell temperatura më të larta, veçanërisht në zonat tropikale. Sipas Samantha Burgess, drejtuese strategjike për klimën në Copernicus, El Niño po i shton më tej temperaturat e oqeanëve. Ngrohja e vazhdueshme e oqeanëve po shton presionin mbi ekosistemet detare dhe komunitetet bregdetare. Një nga pasojat më të rënda është dëmtimi dhe shkatërrimi i shkëmbinjve koralorë në mbarë

botën, i cili konsiderohet një prej rreziqeve kryesore të ndryshimeve klimatike. Sipas Copernicus, temperaturat më të larta të detit rrisin gjithashtu rrezikun për fenomene ekstreme të motit. Oqeanet më të ngrohta çlirojnë më shumë nxehtësi dhe lagështi në atmosferë, duke krijuar kushte për reshje më intensive dhe stuhi më të fuqishme. Në të njëjtën kohë, një oqean më i ngrohtë mund të thithë më pak dioksid karboni nga atmosfera, e kjo dobëson një prej mekanizmave natyrorë më të rëndësishëm që ndihmojnë në kufizimin e ndryshimeve klimatike.

PDK DHE ALEANCA AKUZOJNË KURTIN PËR BLLOKIM TË INSTITUCIONEVE

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 GUSHT - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Aleanca kanë kërkuar sërish kthimin e kushtetutshmërisë dhe vazhdimin e seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës, duke akuzuar kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, se po e mban të bllokuar procesin e konstituimit të institucioneve.

Asamblistja e Kuvendit Komunal të Prishtinës, Fjolla Vukshinaj-Reçica, tha se pasojat e bllokimit të Kuvendit prekin drejtpërdrejt qytetarët, familjet dhe komunat. “Bllokimi i Kuvendit të Kosovës nuk është një debat abstrakt politik. Nuk është vetëm një derë e mbyllur në këtë ndërtesë. Pas çdo dite që Kuvendi mbahet i bllokuar, është një qytetar që pret, një familje që ka një hall, një komunë që ka një projekt dhe një nevojë që mbetet pa zë. Këto janë pasojat reale të institucioneve të bllokuara. Sepse një Kuvend që nuk funksionon nuk mund t'i trajtojë siç duhet nevojat e qytetarëve, nuk mund të zhvillojë debatin për politikën dhe buxhetet që u duhen komunave dhe nuk mund t'i

mbajë institucionet përgjegjëse”, deklaroi Vukshinaj-Reçica.

Deputetja e PDK-së, Blerta Deliu, tha se Kurti dhe ministrat e tij duhet të largohen nga Qeveria në detyrë dhe të kthehen në Kuvend, në mënyrë që t'i hapet rrugë krijimit të institucioneve të reja. “Jemi këtu për të përsëritur edhe një herë kërkesën tonë për kthimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Pra, ne po i themi sot troç Albin Kurtit dy gjëra. E para, ai dhe ministrat e tij, të cilët janë në këtë objekt, janë uzurpatorë dhe duhet ta lirojnë këtë objekt. E dyta, ata duhet të kthehen në Kuvend dhe t'i hapin rrugë krijimit të institucioneve të reja të vendit. Kosova po stagnon dhe, me të drejtë, e tha sot edhe asamblistja e Komunes së Prishtinës, sepse pasojat po i ndejnë qytetarët e Republikës. Dëmi është shumë i madh dhe ka vetëm një njeri që sot nuk lodhet për stagnimin në të gjitha drejtimet që e ka Republika e Kosovës. Prandaj, nga këtu i themi deputetit Kurti që të kthehet në Kuvend dhe t'i hapë rrugë krijimit të institucioneve të reja, sepse Kosova është projekt shekullor i shumë brezave dhe nuk mund ta shkatërrojë askush, as



deputeti Kurti”, tha Deliu. Ndërkaq, deputeti i Aleancës, Besnik Tahiri, e akuzoi Kurtin se po pengon konstituimin e Kuvendit dhe po cenon mandatin e deputetëve të zgjedhur nga qytetarët. “Porosia është shumë e thjeshtë: shkelësi recidivist i Kushtetutës vazhdon të struket në zyrën e vet. Ai 120 deputetëve të Kuvendit të

Kosovës ua ka marrë mandatin që ua ka dhënë populli. Një njeri i vetëm nuk lejon që ta ushtrojmë detyrën tonë si të zgjedhur të popullit, të votuar nga sovrani në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ai e ka bllokuar konstituimin e Kuvendit të Kosovës me të vetmin qëllim, për ta gjetur diku një derë që edhe pozicionin e

presidentit ta kapë për partinë e vet dhe ta kthejë logjikën e partisë që e udhëheq në parti-shtet. Mandati është i yni, i deputetëve që na e ka dhënë populli. Këtë mandat nuk guxon as Albin Kurti, as askush tjetër, të na e marrë. Veprimet që po bëhen po e pengojnë konstituimin e Kuvendit”, tha Tahiri.

BARALIU: MOSTHIRRJA E SEANCËS MUND TË JETË PËR SHTYRJEN E AFATEVE DHE ZGJEDHJET E MUNDSHME

PRISHTINË, 25 GUSHT - Pas zgjedhjeve, Kuvendi i Kosovës ende nuk është konstituuar, ndërsa përplasjet politike mes LVV-së dhe partive opozitare po e mbajnë të bllokuar institucionin.

PDK-ja dhe AAK-ja kanë refuzuar bashkëpunimin me LVV-në për formimin e institucioneve, ndërsa LDK-ja ka kundërshtuar një marrëveshje për Qeverinë, por ka lënë të hapur mundësinë për zgjedhjen e presidentit. Ngërçi politik po vazhdon, ndërsa palët nuk kanë arritur marrëveshje për tejkalimin e situatës.

Njohësit e çështjeve kushtetuese vlerësojnë se



tashmë janë tejkaluar afatet kushtetuese për konstituimin e Kuvendit, ndërsa, sipas tyre, partia fituese po shkel dispozitat ligjore dhe kushtetuese me zvarritjen e procesit.

Njohësi i çështjeve kushtetuese, Mazlum Baraliu, ka thënë për “Front Online” se pas certifikimit të rezultateve, seanca konstituive e Kuvendit është dashur të thirret dhe të përfundojë brenda afateve të përcaktuara.

Baraliu ka thënë se seanca është dashur të thirret çdo 48 orë deri në përfundimin e saj, duke e cilësuar situatën aktuale si shkelje. “Është dashur që çdo 48 orë të thirret

seanca dhe të përfundojë kjo. Shkelje ka dhe kjo nuk është hera e parë, se krejt kjo klasë politike është e papërgjegjshme dhe po bëjnë shkelje”, ka thënë Baraliu.

Sipas tij, një nga arsyet e mundshme për mos-thirrjen e seancës mund të jetë përpjekja për arritjen e një marrëveshjeje politike për zgjedhjen e presidentit.

“Arsyeja e mosthirrjes së seancës është për gjetjen e një marrëveshjeje për presidentin. Nëse ka qëllim për shtyrje të afateve, për të caktuar sa më vonë pastaj zgjedhje, edhe kjo është një mundësi. Varet prej qëllimeve që kanë”, tha Baraliu.

Uran Ismaili: Qytetarët po paguajnë çmimin e bllokadës institucionale

PRISHTINË, 25 GUSHT - Deputeti i PDK-së, Uran Ismaili, ka kritikuar situatën aktuale politike në vend, duke thënë se qytetarët e Kosovës po e paguajnë çmimin e krizës dhe bllokadës institucionale.

Përmes një postimi, Ismaili ka akuzuar kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, se po e mban vendin në bllokadë për shkak të kalkulimeve politike.

“Populli i Kosovës nuk mund të mbahet peng për shkak të kalkulimeve politike të një partie apo të një njeriu”, ka shkruar Ismaili.

Ai ka bërë thirrje që të vazhdojë seanca konstituive, të konstituohet Kuvendi dhe institucionet e shtetit t'i kthehen punës.

Sipas Ismailit, prioritet duhet të jetë respektimi i Kushtetutës së

Kosovës. “Ne nuk do të ndalemi dhe nuk do të tërhiqemi derisa Kuvendi të konstituohet, institucionet të funksionalizohen dhe Kosova t'u kthehet qytetarëve”, ka deklaruar ai.

Ismaili ka theksuar se mobilizimi i tyre do të vazhdojë deri në fund, pasi, sipas tij, qytetarët e Kosovës meritojnë më mirë.



'MË 16 SHTATOR PRESIM FITOREN E DYTË TË KOSOVËS', QYTETARËT PRESIN LIRIMIN E ISH-KRERËVE TË UÇK-së



Në prag të vendimit përfundimtar në Hagë, qytetarët presin lirimin e ish-krerëve të UÇK-së dhe e cilësojnë 16 shtatorin si një ditë vendimtare për Kosovën. Ndërkaq, platforma qytetare "Liria ka Emër" ka vendosur në Prishtinë të ashtuquajturën "Ora e Pritjes", një ekran gjigant që do të numërojë ditët, orët, minutat dhe sekondat deri më 16 shtator, në shenjë pritjeje dhe mbështetjeje për ish-krerët e UÇK-së. Në qytete të ndryshme të Kosovës ka nisur gjithashtu vendosja e banerëve me mesazhin "Kosova po pret", si dhe e flamujve me logon e UÇK-së

PRISHTINË, 25 GUSHT - Teksa afrohet 16 shtatori, vëmendja mbetet e përqendruar te vendimi përfundimtar për ish-krerët e UÇK-së, të cilët po gjykohen në Hagë. Qytetarët në Kosovë shprehen me shpresë se ata do të shpallen të pafajshëm dhe do të kthehen në Kosovë.

Në prag të shpalljes së vendimit, qytetarë të intervistuar nga Ekonomia Online kanë thënë se presin lirimin e ish-krerëve të UÇK-

së, duke e cilësuar procesin gjyqësor ndaj tyre si të padrejtë.

Nuha Bislimi tha se pret që ish-krerët e UÇK-së të lirohen dhe të kthehen sa më shpejt në Kosovë. "Mendoj që po, edhe dëshiroj të lirohen, të jenë të lirë. Sepse me padrejtësi po rrinë atje. Jo, jo, çfarë të drejte? Nuk ka qenë i drejtë, i padrejtë totalisht. Ne presim të lirohen sa më shpejt. Keq, boll na mërzitemi të gjithë. E mundshme është, është

padrejtësi e madhe", tha Bislimi.

Të njëjtin qëndrim e shprehu edhe Azem Doda, i cili tha se shpreson që ish-krerët e UÇK-së të kthehen në vendin e tyre. "Inshallah kanë ymër e kthehen në tokën e vet. Aty veç Zoti e di. Ata nuk kanë shkuar me ia zaptuar tokën askujt, veç me mbrojt prapin e vet. Sigurisht që u është bërë e padrejtë", tha Doda.

Ndërkaq, Beqir Lale tha se po e pret me shpresë vendimin e 16

shtatorit, duke shprehur dëshirën që ish-krerët e UÇK-së të lirohen. "Me gjithë dëshirë, me shpirt e me zemër. Po, kur janë marrë, ka qenë vendim i padrejtë dhe edhe tash është vendim i padrejtë. Por, me të gjitha shpresat, më 16 shtator do të jetë fitorja e dytë e Kosovës. Dashtë Zoti të mos merret", tha Lale.

Të shtunën, platforma qytetare "Liria ka Emër" ka vendosur në Prishtinë të ashtuquajturën "Ora e Pritjes", disa ditë para 16

shtatorit, datës kur pritet të shpallet vendimi përfundimtar për ish-krerët e UÇK-së që po gjykohen në Hagë.

Në shesh është vendosur një ekran gjigant, i cili do të numërojë ditët, orët, minutat dhe sekondat deri më 16 shtator, në shenjë pritjeje dhe mbështetjeje për çlirimtarët.

Ndërkaq nëpër qytetet e Kosovës ka filluar vendosja e banerëve "Kosova po pret" dhe flamujt me logon e UÇK-së. Platforma qytetare "Liria ka



OVLUÇK-ja MBËSHTET PROTESTËN E 12 SHTATORIT NË MBËSHTETJE TË ISH-KRERËVE TË UÇK-SË

PRISHTINË, 25 GUSHT- Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së (OVLUÇK) ka bërë të ditur se do ta fokusojë veprimtarinë e saj në rrafshin diplomatik dhe institucional, në lidhje me proceset që po zhvillohen në Gjykatën Speciale në Hagë.

Në një komunikatë për opinionin publik, OVL-UÇK ka njoftuar se Kryesia, e dalë nga Kuvendi i 5-të i organizatës, i mbajtur në janar të vitit 2025, ka ndërmarrë një sërë aktivitete dhe iniciativash kundër asaj që e konsideron si padrejtësi në proceset e Gjykatës Speciale.

Sipas OVLUÇK-së, organizata ka adresuar rreth 300 letra të personalitete të ndryshme ndërkombëtare, prej të cilave 285 u janë dërguar anëtarëve të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Po ashtu, thuhet se janë zhvilluar takime me shumicën e ambasadorëve të vendeve mike të akredituar

në Kosovë, si dhe me kryetarët e partive politike, me përjashtim të kryetarit të LJV-së.

OVLUÇK ka përmendur edhe takimet e zhvilluara me përfaqësues ndërkombëtarë në Parlamentin e Zvicrës, Parlamentin Evropian dhe Vatikan, si dhe takimin me kryetaren e Veteranëve të SHBA-së, Carol Whitmore. Organizata ka bërë të ditur se ka organizuar edhe një peticion me rreth 200 mijë nënshkrime, i cili, sipas saj, është dorëzuar në Gjykatën Speciale më 6 maj 2026, me kërkesë për drejtësi dhe trajtim të drejtë të proceseve ndaj ish-krerëve të UÇK-së.

Në komunikatë janë renditur edhe disa nga protestat dhe aksionet e organizuara në Prishtinë, Hagë, Tiranë, Strasburg, Maqedoninë e Veriut dhe Kroaci.

Duke iu referuar protestës së paralajmëruar për 12 shtator,



OVLUÇK ka njoftuar se ka marrë vendim që aktivitetin e saj ta përqendrojë në rrafshin diplomatik dhe institucional, ndërsa do të marrë pjesë edhe në aktivitetet e tjera që do të organizohen deri më 16 shtator. “Ky vendim është marrë duke u bazuar në qëndrimin tonë të pandryshuar që nga themelimi i Gjykatës Speciale, pasi kemi

qenë dhe vazhdojmë të jemi të bindur se ajo është një gjykatë politike dhe se proceset e saj vazhdojnë të jenë të ndikuara politikisht”, thuhet në komunikatën e OVLUÇK-së. Sipas organizatës, duke pasur parasysh zhvillimet e fundit dhe mundësinë e një vendimi me karakter politik, veprimtaria do të fokusohet në diplomaci dhe institucione.

Në të njëjtën mbledhje, Kryesia e OVLUÇK-së ka marrë vendim për përjashtimin e anëtarit Skënder Llugiqi nga organizata. Sipas komunikatës, vendimi është marrë në bazë të Statutit të OVLUÇK-së, për shkak të deklaratave publike të Llugiqit kundër gjeneralit Ramush Haradinaj, të cilat Kryesia i ka vlerësuar si shkelje të Statutit.



Emër”, më 12 shtator në Prishtinë organizon Marshin për Liri nën moton: Kosova po pret.

Ky marsh do të mbahet katër ditë para se të merret vendikti nga Dhomat e Specializuara në Hagë, për themeluesit dhe drejtuesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Përfaqësuesit e platformës “Liria ka Emër”, Eliza Hoxha dhe Ismail Tasholli, në një konferencë për media, kanë shpalosur aktivitetet që do t'i paraprijnë dhe do ta pasojnë këtë marsh.

Hoxha tha se tash e 6 vite kjo platformë, bashkë me qytetarët kanë shfaqur kërkesën për gjykim të drejtë. “Dhe për 6 vite e kemi parë të gjitha aktakuzat e Prokurorisë kanë qenë të paqëndrueshme dhe janë rrëzuar një nga një. Por, 16 shtatori duhet të jetë përfundimi i kësaj sage të errët.

Dhe ne do të vazhdojmë të jemi pranë tyre. Jo duke paragjykuar vendimin e drejtësisë dhe jo duke ndërhyrë në procesin gjyqësor, por duke e bërë të dëgjueshëm zërin qytetar për drejtësi, dinjitet, kujtesë dhe respekt ndaj historisë sonë”, tha ajo.

Hoxha tregoi se nga nesër fillojnë dy aktivitete, numërimi mbrapsht deri më 16 shtator dhe “Netët e lirisë”. “Aktiviteti i parë fillon nesër, në ora 10:00 në Prishtinë. Do të vendosim një countdoën - numërim mbrapsht, i cili do të numërojë kohën deri më 16 shtator, në ora 10:00, kur pritet seanca e fundit e përmbylljes së procesit në Hagë. I njëjti aktivitet do të jetë i shtrirë në të gjitha komunat e Kosovës. Çdo orë që kalon do të na kujtojë se Kosova po pret. Pret drejtësi. Pret dinjitet. Pret çlirimtarët të

kthehen në shtëpinë e vet. Aktiviteti ynë i dytë, Netët e Lirisë do të zhvillohet në shtatë zonat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Netët e Lirisë do të jenë net të kujtesës, të rrëfimit dhe të bashkimit mes brezave për rrugën e vështirë dhe sakrificat për liri”, shtoi ajo. Ndërkaq, Ismail Tasholli ftoi të gjithë spektrin politik të Republikës së Kosovës t'i bashkohet këtij marshi. “I ftojme të gjitha partitë politike shqiptare dhe liderët e 4 partive më të mëdha më vend, z. Kurti, z. Hamza, z. Abdixhiku, z. Gjini që të bëhen pjesë e Marshit për Liri. Kjo ftesë u drejtohet të gjithëve, pa përjashtim. I ftojme këta të jenë të pranishëm dhe të kenë adresimin e tyre publik në Marshin për Liri. Jo për të bërë fushatë. Jo për të ngritur flamuj partiakë. Por për

Kosovën, për lirinë, për të ardhmen”, tha ai.

Tasholli njoftoi se kjo platformë do të zhvillojë edhe një aktivitet në Hagë me diasporën shqiptare, më 16 shtator. “Më 16 shtator, kur vëmendja do të jetë e përqendruar në Hagë, ‘Liria ka Emër’ do të organizojë aktivitet edhe në Hagë, së bashku me diasporën shqiptare. Nga Kosova deri në Hagë, mesazhi ynë do të jetë i njëjtë: Kosova po pret. Prandaj, nga nesër në sheshin e Prishtinës fillon numërimi mbrapsht. Nga 16 shtatori, Kosova më nuk do të jetë njësoj”, theksoi ai.

Procesi gjyqësor në Hagë tashmë po shkon drejt përfundimit. Sipas njoftimeve, deklaratat përmbyllëse janë caktuar të mbahen më 10, 11 dhe 14 shtator.

Dhomat e Specializuara të Kosovës, të njohura si Gjykata Speciale, u themeluan në vitin 2015 nga Kuvendi i Kosovës.

Ato janë pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës, ndërsa veprojnë me seli në Hagë të Holandës dhe me personel ndërkombëtar.

Procesi ndaj ish-krerëve të UÇK-së është përcjellë me reagime dhe kundërshtime të shumta në Kosovë. Një pjesë e opinionit publik e ka konsideruar atë si proces të njëanshëm, duke ngritur shqetësime për mos-përfshirjen në këtë proces të krimeve të kryera nga forcat serbe gjatë luftës në Kosovë.

Në shenjë mbështetjeje për ish-krerët e UÇK-së dhe me thirrje për drejtësi, gjatë viteve të fundit janë organizuar protesta dhe tubime në Prishtinë, Hagë, Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut.

147 raste me fruth në Kosovë që nga prilli, IKShPK apelon për vaksinim

Prishtinë, 25 gusht - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se, gjatë periudhës 16 prill - 24 gusht 2026, në Kosovë janë raportuar gjithsej 147 raste të konfirmuara me fruth. Ky numër përfaqëson më shumë se dyfishin e rasteve të konfirmuara gjatë tërë vitit 2025. Vetëm gjatë javës së fundit janë regjistruar 10 raste të reja. Sipas komunave, numër më i lartë i rasteve raportohet nga komuna e Prishtinës me dyzet e

nëntë (49) raste, Fushë-Kosovë me tridhjetë e pesë (35) raste; Ferizaj me trembëdhjetë (13) raste; Obiliq me nëntë (9) raste; Lipjan me tetë (8) raste; Kaçanik me shtatë (7) raste; Vushtrri dhe Shtime me nga katër (4) raste; Skenderaj dhe Drenas me nga tre (3) raste; Gjilan, Gjakovë, Shtërpce dhe Deçan me nga dy (2) raste; si dhe me nga një (1) rast komunat:, Graçanicë, Mitrovicë, Podujevë, Suharekë dhe Viti.

Gjatë 3 javëve të fundit, ekipet e vaksinimit në komunat me numrin më të lartë të rasteve të fruthit (Prishtinë, Fushë Kosovë, Ferizaj, Obiliq, Vushtrri dhe Skenderaj), kanë intensifikuar aktivitetet, me ç'rast janë vaksinuar me MMR gjithsej 504 fëmijë të vonuar për vaksinim sipas kalendarit të rregullt të vaksinimit. IKShPK rekomandon që çdo person me simptoma të dyshimta të fruthit, si temperaturë e lartë, skuqe apo

ndryshime në lëkurë, kollë, rrufë ose konjuktivit, të paraqitet menjëherë në institucionet më të afërta shëndetësore. Duke pasur parasysh infektueshmërinë e lartë të fruthit, rrezikun e përhapjes së tij në komunitet dhe komplikimet që shkakton fruthi, IKShPK u bën thirrje prindërve dhe kujdestarëve që të verifikojnë statusin e vaksinimit të fëmijëve të tyre dhe të sigurojnë vaksinimin



sipas Kalendarit të rregullt të vaksinimit në qendrat e mjekësisë familjare. Vaksinimi mbetet mënyra më e sigurt dhe më efektive për parandalimin e fruthit, uljen e përhapjes së sëmundjes në komunitet dhe mbrojtjen e shëndetit publik.

DIOGUARDI DHE POWLES NË BIBLIOTEKËN KOMBËTARE, VLERËSOHET KONTRIBUTI I TYRE PËR KOSOVËN

PRISHTINË, 25 GUSHT - Drejtoresha e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, Blerina Rogova Gaxha, mirëpriti në takim Joseph J. DioGuardi, ish-kongresmenin amerikan dhe themeluesin e Ligës Qytetare Shqiptaro-Amerikane (AACL), Shirley Cloyes DioGuardi, këshilltare për çështjet e Ballkanit në këtë organizatë, dhe juristin britanik Steven Powles KC, specialist i së drejtës penale ndërkombëtare, krimeve të luftës dhe të drejtave të njeriut. Prania e tyre në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës ishte një rast i veçantë për të shprehur

mirënjohjen dhe respektin për kontributin e tyre shumëvjeçar në mbështetje të Kosovës dhe të së drejtës së popullit të saj për liri, demokraci dhe pavarësi. Që nga themelimi i Ligës Qytetare Shqiptaro-Amerikane në vitin 1989, Joseph DioGuardi dhe Shirley Cloyes DioGuardi kanë qenë zëra të fuqishëm në Uashington dhe në arenën ndërkombëtare për sensibilizimin e institucioneve amerikane dhe opinionit publik mbi gjendjen e shqiptarëve në Kosovë. Steven Powles KC në vitin 1999 punoi në Kosovë me International Crisis Group, në

kuadër të punës për hetimin e krimeve të luftës të kryera gjatë konfliktit. Përmes punës së tyre me Kongresin e Shteteve të Bashkuara, institucione të ndryshme dhe figura të rëndësishme politike, ata kontribuan në vendosjen e çështjes së Kosovës në agjendën e politikës së jashtme amerikane. Për Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, takimi i sotëm ishte një moment kujtese, nderimi dhe mirënjohjeje për miqtë që i qëndruan pranë Kosovës në rrugëtimin e saj drejt lirisë dhe pavarësisë.



NGRIHET AKTAKUZË NDAJ FATMIR SHEHOLLIT PËR SPIUNAZH DHE SHANTAZH

PRISHTINË, 25 GUSHT - Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur aktakuzë ndaj Fatmir Shehollit, duke e akuzuar se ka bashkëpunuar me Agjencinë e Sigurisë dhe Informacionit të Serbisë (BIA) dhe se, në një rast tjetër, ka shantazhuar një person për një shumë prej mbi 13 mijë eurosh. Sheholli akuzohet për dy vepra penale: “spiunazh” dhe “shantazh”. Sipas aktakuzës, në një periudhë të papërcaktuar kohore deri më 9 tetor 2025, Sheholli dyshohet se ishte rekrutuar nga BIA dhe se kishte vepruar sipas udhëzimeve dhe detyrave të zyrtarëve të këtij shërbimi. Prokuroria pretendon se ai kishte mbledhur dhe siguruar informacione e dokumente që lidheshin me zhvillimet politike, situatën e sigurisë dhe funksionimin e institucioneve të Kosovës. Këto të dhëna, sipas aktakuzës, ai ua kishte përcjellë zyrtarëve të shërbimit serb përmes



mesazheve telefonike. Përveç akuzës për spiunazh, Sheholli përballët edhe me akuzën për shantazh. Prokuroria pretendon se, nga viti 2022 deri në dhjetor të vitit 2025, ai kishte shantazhuar një person me inicialet A.J., duke e detyruar të vepronte në dëm të pasurisë së tij. Vlera e dëmit, sipas aktakuzës, tejkalon 13 mijë euro. Sheholli dyshohet se i kishte kërkuar para këtij personi në formë huazimi dhe e kishte kërcënuar se, nëse nuk ia jepte paratë, do të publikonte në media video dhe informacione që mund t'ia dëmtonin rëndë reputacionin dhe autoritetin. Aktakuza tashmë i është dorëzuar Gjykatës Themelore në Prishtinë për shqyrtim. Sheholli vazhdon të mbahet në paraburgim. Sheholli është arrestuar në tetor të vitit 2025 nën dyshimin për spiunazh. Në atë kohë, Prokuroria Speciale e Kosovës nuk ka dhënë hollësi se për kë dyshohej

se kishte spiunuar. Megjithatë, në ditën e arrestimit, ministri në detyrë i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka lënë të kuptohet se dyshimet lidheshin me Serbinë. Sveçla ka deklaruar se Sheholli gëzonte “hapësira të pakufizuara” në mediat e Kosovës dhe se kishte “bashkëpunuar me aktorë që çdo ditë punojnë e veprojnë për të minuar Republikën tonë dhe progresin e saj”. Rasti i Shehollit është një nga disa raste të spiunazhit të dyshuar për Serbinë që autoritetet kosovare kanë hetuar viteve të fundit. Në qershor të vitit të kaluar, Gjykata Themelore në Prishtinë ka dënuar Aleksandar Vllajiqin me pesë vjet burgim, pasi ai është deklaruar fajtor për spiunazh si anëtar i Agjencisë serbe të Inteligjencës dhe Sigurisë (BIA), ndërsa Bedri Shabani dhe Muharrem Qerimi po gjykohen, gjithashtu, nën akuzat për spiunazh për Serbinë.

Llugaliu pret homologun maqedonas, në fokus reformat doganore

PRISHTINË, 25 GUSHT - Drejtori i Përgjithshëm i Doganës së Kosovës, Agron Llugaliu, ka pritur të martën në takim zyrtar drejtorin e përgjithshëm të Administratës Doganore të Maqedonisë së Veriut, Boban

Nikollovski, dhe zëvendës drejtorin Mustafa Dauti, me të cilët ka diskutuar për bashkëpunimin dhe reformat doganore ndërmjet dy vendeve. Në këtë takim, Llugaliu tha se

bashkëpunimi me Doganën e Maqedonisë së Veriut ka sjellë rezultate pozitive, veçanërisht në reformën për deklarimin para mbërritjes, ndërsa theksoi rëndësinë e shkëmbimit të informacionit dhe përvojave.

Ndërkaq, drejtori i Përgjithshëm i Administratës Doganore të Maqedonisë së Veriut, Boban Nikollovski, tha se është i kënaqur me bashkëpunimin ndërmjet dy administratave doganore.



136 lindje brenda një jave në Klinikën e Gjinekologjisë në QKUK

PRISHTINË, 25 GUSHT - 136 lindje brenda një jave në Klinikën e Gjinekologjisë në QKUK. Në Klinikën e Gjinekologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), gjatë javës së fundit janë realizuar gjithsej 136 lindje.

Sipas të dhënave të publikuara nga QKUK, prej tyre 77 lindje kanë qenë spontane, ndërsa 59 lindje janë kryer me prerje cezariane. Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar edhe katër lindje gemellare (binjakë) dhe një

lindje trigemellare (trejakë). Sa i përket gjinisë së të porsalindurve, janë regjistruar 74 djem dhe 68 vajza. Klinika e Gjinekologjisë gjatë kësaj jave ka ofruar kujdes profesional për rastet obstetrikale, duke përfshirë

lindjet spontane dhe operative, si dhe menaxhimin e shtatzënive multiple. QKUK ka theksuar se mbetet e përkushtuar në ofrimin e shërbimeve shëndetësore cilësore dhe profesionale për nënat dhe të porsalindurit.



NDAHET NGA JETA EQREM KRYEZIU



Faton DËRMAKU

PRIZREN, 25 GUSHT - Të martën i është dhënë lamtumira e fundit te varrezat e reja të qytetit të Prizrenit, profesorit universitar dhe politikanit, Eqrem Kryeziu, i cili ndërroi jetë në moshën 78-vjeçare. Nën patronatin e Komunës së Prizrenit është mbajtur një mbledhje komemorative për nder të të ndjerit në Shtëpinë e Kulturës “Xhemajli Berisha” në Prizren. Eqrem Kryeziu do të mbahet mend për kontributin e tij në politikën kosovare, veçanërisht në Prizren, si dhe për angazhimin e tij në jetën akademike. Vdekja e tij përbën një humbje për familjen, miqtë, bashkëpunëtorët dhe komunitetin politik e akademik të Kosovës. Eqrem Kryeziu ka qenë kryetar i Komunës së Prizrenit, kryetar i Degës së LDK-së në Prizren, nënkryetar i LDK-së në nivel qendror dhe deputet i Kuvendit të Kosovës në disa mandate. Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka shprehur ngushëllime për ndarjen nga jeta të profesorit dhe ish-kryetarit të Komunës së Prizrenit, Eqrem Kryeziu.



Abdixhiku ka thënë se Kosova ka humbur një intelektual të shquar, një veprimtar të orëve të para dhe një shërbyes të përkushtuar të institucioneve të vendit. Sipas tij, LDK-ja ka humbur një prej figurave të saj më të rëndësishme, ndërsa Prizreni një personalitet që e përfaqësoi dhe e udhëhoqi me dinjitet. “Profesor Eqremi ishte pjesë e brezit themeltar të

LDK-së dhe bashkudhëtar i palëkundur i Presidentit Rugova. Për më shumë se dy dekada udhëhoqi Degën e LDK-së në Prizren, shërbeu si nënkryetar i parë i LDK-së, deputet e kryetar i Komunës së Prizrenit në vitet e para e më të vështira të lirisë”, ka shkruar Abdixhiku. Ai e ka përshkruar Kryeziun si profesor, intelektual dhe veprimtar politik me mendim

të lirë, fjalë të drejtpërdrejtë dhe karakter të veçantë. “LDK-së i dha vite të tëra angazhimi, besnikërie dhe shërbimi; Kosovës i shërbeu në arsim, në politikë dhe në ndërtimin e institucioneve demokratike”, ka theksuar Abdixhiku. Në fund, kryetari i LDK-së u ka shprehur ngushëllime familjes Kryeziu, miqve, bashkëpunëtorëve dhe qytetarëve të Prizrenit.

“Profesor Eqrem, faleminderit për gjithë kontributin dhe gjurmën që le pas. Pusho në paqe! I përhershëm qoftë kujtimi për ty!”, ka përfunduar Abdixhiku. Kryetari i Prizrenit, Shaqir Totaj, ka thënë se me dhimbje të thellë ka marrë lajmin për ndarjen nga jeta të intelektualit të shquar, profesorit dhe veprimtarit të dalluar, prof. dr. Eqrem Kryeziu. Ai ka thënë se profesor Kryeziu la gjurmë të pashlyeshme në historinë tonë të re si një nga themeluesit dhe figurat qendrore të Lidhjes Demokratike të Kosovës, si dhe në udhëheqjen e zhvillimin e qytetit të Prizrenit. “Kontributi i tij në sferën akademike si profesor i letërsisë shqipe dhe në konsolidimin e institucioneve të Kosovës do të kujtohet gjithmonë me respekt të lartë. Ngushëllime të sinqerta familjes Kryeziu, miqve, kolegëve dhe gjithë bashkëpunëtorëve! I përjetshëm qoftë kujtimi për të! Rri në paqe, Profesor!”, ka shkruar Totaj në ngushëllimin e tij. Ngushëllime familjes Kryeziu i kanë shprehur edhe liderët e partive politike në vend, deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe veprimtarë të LDK-së.

GARAT E SHPEJTËSISË RREZIKOJNË JETË, POLICIA APELON PËR PËRGJEGJËSI NË KOMUNIKACION



GJAKOVË, 25 GUSHT - Drejtoria Rajonale e Policisë në Gjakovë ka njoftuar se në dy raste të ndara, zyrtarët policorë të patrullave dhe Njësisë Rajonale të Trafikut Rrugor kanë ndërhyrë për të ndaluar zhvillimin e garave të shpejtësisë brenda në qytet. Në rrugën “Martirët Querkezi” janë identifikuar dy motoçikleta duke marrë pjesë në gara të shpejtësisë. Në rrugën “Gaspër Karaqi” janë hasur dy automjete duke kryer gara të

ngjashme. Falë reagimit të menjëhershëm, policia ka arritur të ndalojë këto kundërvajtje të rrezikshme, të cilat cenonin drejtpërdrejtë sigurinë e qytetarëve dhe ndaj personave të përfshirë janë shqiptuar gjoba në përputhje me legjislacionin në fuqi. Policia e Kosovës rikujton se garat e shpejtësisë dhe sjelljet e papërgjegjshme në komunikacion janë ndër shkaqet kryesore të aksidenteve me pasoja fatale.

Vetëm gjatë këtij viti, si pasojë e aksidenteve të trafikut, kemi regjistruar një numër të lartë viktimash, çka e bën edhe më urgjente nevojën për respektimin e rregullave të trafikut rrugor. Drejtoria Rajonale e Policisë në Gjakovë apelon tek të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion që të sillen me përgjegjësi, të shmangin veprimet e rrezikshme dhe të kontribuojnë së bashku për rritjen e sigurisë rrugore.

Përurohet Tregu i Veturave në Bërnicë të Poshtme

PRISHTINË, 25 GUSHT - Në Bërnicë të Poshtme në Prishtinë është përuar Tregu i Veturave, projekt ky i realizuar nga Drejtoria e Investimeve

Kapitale e Kryeqytetit, i cili sipas kryetarit të Prishtinës, Përparim Rama, do të shërbejë edhe për funksione të tjera. Rama ka bërë me dije se në

këtë hapësirë do të bartet tregu i makinave, ndërsa përkohësisht do të shfrytëzohet edhe për tregun e druve.

Ai tha se janë paraparë gjithsej katër funksione për këtë hapësirë, përfshirë edhe poligonin për autoshkolla dhe sistemin “Park and Ride”.



KOSOVA E VARUR NGA MISHI BRAZILIAN, NDËRSA BE-ja VENDOS KUFIZIME

PRISHTINË, 25 GUSHT - Mbi 50 milionë euro mish gjedhi dhe pule nga Brazili ka importuar Kosova vetëm në shtatë muajt e parë të këtij viti. Brazili është furnizuesi më i madh i Kosovës me këto produkte, por nga 3 shtatori një pjesë e eksporteve të tij me origjinë shtazore do të përballlet me kufizime në Bashkimin Evropian. Arsyeja lidhet me rregullat e BE-së për përdorimin e antimikrobikëve te kafshët që përfundojnë në zinxhirin ushqimor. Shqipëria ka njoftuar se do të zbatojë masa të ngjashme nga e njëjta datë. Kosova, deri më tani, nuk ka njoftuar për ndonjë masë, ndonëse një pjesë e konsiderueshme e mishit që importon, vjen pikërisht nga ky shtet i Amerikës Jugore. Sipas të dhënave të Doganës së Kosovës, nga janari deri në korrik të vitit 2026, vlera e mishit të gjedhit dhe të pulës të importuar nga Brazili ka kaluar 50 milionë euro. Për krahasim, importet e këtyre dy llojeve të mishit nga të gjitha shtetet e tjera së bashku kanë arritur në mbi 65 milionë euro gjatë së njëjtës periudhë. Në këto shifra nuk përfshihen kafshët e gjalla që importohen për therje dhe as produktet e përpunuara të mishit të gjedhit dhe të pulës.


Pse BE-ja po vendos kufizime?

Sipas rregullave të Bashkimit Evropian, kafshët e gjalla dhe produktet me origjinë shtazore që importohen nga vendet e treta nuk duhet të vijnë nga kafshë të trajtuara me produkte antimikrobiale për nxitjen e rritjes ose rritjen e prodhimit. Një zëdhënës i Komisionit Evropian tha për Radion Evropa e Lirë se, nga 3 shtatori 2026, të gjitha kafshët dhe produktet me origjinë shtazore për konsum njerëzor që eksportohen drejt BE-së, duhet t'i përmbushin këto kërkesa. "Brazili u përjashtua nga lista e vendeve të autorizuar, sepse nuk kishte ven-

dosur masat e nevojshme për t'i dhënë BE-së garanci se rregullat për përdorimin e antimikrobikëve janë respektuar gjatë gjithë ciklit jetësor të kafshëve", thuhet në përgjigjen e Komisionit Evropian. Antimikrobikët janë substanca që përdoren për të luftuar mikroorganizmat që shkaktojnë sëmundje. Në këtë grup bëjnë pjesë edhe antibiotikët. Profesori i sigurisë ushqimore në Universitetin e Prishtinës, Sali Salihu, thotë se përdorimi i pakontrolluar i antibiotikëve në blegtori mund të favorizojë krijimin e baktereve rezistente, të cilat mund të kalojnë te njerëzit edhe përmes zinxhirit ushqimor. "Kur bakteret bëhen rezistente ndaj antibiotikëve, trajtimi i infeksioneve te njerëzit bëhet shumë më i vështirë dhe sëmundja mund të zgjasë më shumë", thotë Salihu për Radion Evropa e Lirë. Për këtë arsye, ai vlerëson se edhe Kosova duhet t'i shqyrtojë masat e ndërmarra nga Bashkimi Evropian, sidomos për shkak të varësisë së madhe nga importet braziliane. "Kosova duhet t'i harmonizojë edhe ligjet, edhe vendimet me BE-në", thotë ai.

A duhet Kosova ta ndjekë BE-në?

Kosova nuk është anëtare e Bashkimit Evropian dhe, ndryshe nga vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, nuk e ka statusin e vendit kandidat, ndonëse ka aplikuar për anëtarësim në dhjetor të vitit 2022. Komisioni Evropian sqaron se masa për importet zbatohet për shtetet anëtare të BE-së. "Në kuadër të negociatave për anëtarësim në BE, vendet candidate do të duhet të harmonizojnë plotësisht legjislacionin e tyre me kërkesat e BE-së deri në momentin e anëtarësimit", thuhet në përgjigjen e Komisionit. Ministria e Bujqësisë e Kosovës nuk iu përgjigj pyetjeve të Radios Evropa e Lirë nëse po shqyrton masa të ngjashme ndaj importeve nga Brazili.



Çfarë do të ndodhte nëse kufizohen importet?

Çdo kufizim eventual ndaj mishit brazilian do të prekte një treg që tashmë varet në masë të madhe nga importet. Sipas të dhënave të Ministrisë së Bujqësisë, prodhimi vendor i mishit mbulon vetëm 34.2 për qind të nevojave për konsum, ndërsa konsumi vjetor i mishit është rreth 35.7 kilogramë për banor. Mishi i importuar nga Brazili gjendet në markete dhe mish-tore, por, sipas Salihut, përdoret veçanërisht në sektorin e gastronomisë, ndër të tjera për shkak të çmimit më të ulët. Derisa një kilogram mish i freskët i gjedhit në mish-tore mund të kushtojë deri në 15 euro, mishi i ngrirë i importuar nga Brazili mund të blihet për më pak se 10 euro për kilogram. Salihu ngre pikëpyetje për cilësinë dhe mënyrën e trajtimit të mishit të importuar. "Mishi i importuar nuk ka një garanci të cilësisë. Në shumicën e rasteve ai vjen i ngrirë, këtu përpunohet. Por, nuk e dimë se sa ka qëndruar në depot e Brazilit apo në shtetet e tjera të origjinës. Nuk e dimë as mënyrën e trajtimit të kafshëve, nëse janë për-

dorur aditivë, hormone apo antibiotikë", thotë ai. Përfaqësuesit e sektorit të hotelierisë paralajmërojnë për anën tjetër të problemit: nëse importet nga Brazili kufizohen pa burime alternative furnizimi, çmimet mund të rriten. Kryetari i Odës së Hotelierisë dhe Turizmit të Kosovës, Hysen Sogojeva, thotë se prodhimi vendor nuk është i mjaftueshëm për t'i plotësuar nevojat e tregut. "Kosova nuk ka prodhim të mjaftueshëm të këtyre produkteve. Mungesë të mishit ka edhe në rajon, prandaj importohet nga Brazili", thotë Sogojeva për Radion Evropa e Lirë. Sipas tij, shtrenjtimi eventual i mishit do të reflektohej edhe në bizneset e gastronomisë dhe hotelierisë. "Bizneset shërbyese janë të interesuara të furnizohen me mish vendor, por kjo është e pamundur", thotë ai.

A mund të jetë kjo një mundësi për prodhimin vendor?

Salihu thotë se mungesa e mishit të importuar nga Brazili mund të shfrytëzohet si mundësi për të rritur prodhimin vendor. Sipas tij, për këtë nevojitet rritja e fondit blegtoral dhe

mbështetja më e madhe e fermerëve. "Fermerët duhet të investojnë në këtë sektor. Është në interesin e tyre që ky sektor të bëhet i rëndësishëm, sepse kërkesa në treg po rritet. Por, pastaj, edhe shteti duhet ta rrisë fondin blegtoral", thotë Salihu. Kosova i mbështet fermerët përmes subvencioneve dhe granteve investuese. Sipas Raportit të Gjellbër, në vitin 2024, buxheti për Programin e Pagesave Direkte ishte mbi 66 milionë euro. Në kuadër të skemave për blegtorinë, për lopët qumësht-tore janë ndarë 90 euro për një në vit, për therjen e raportuar të gjedheve 50 euro për një dhe për viçat 25 euro për një. Megjithatë, fondi blegtoral nuk ka shënuar rritje të qëndrueshme. Në vitin 2025, Kosova kishte 241.423 gjedhe - rreth 20 mijë më pak se në vitin 2020. Për Salihun, pikërisht këtu duhet kërkuar një pjesë e zgjidhjes për varësinë nga importet. "Çdo fermer që do të shtojë numrin e viçave, qoftë për mish apo për qumësht, mund të ketë interes ekonomik. Kushtet janë, vetëm nevojitet interesimi dhe efektet do të jenë zinxhirore: fiton fermeri, ekonomia, por edhe qytetarët ushqehen me mish cilësor dhe të sigurt", përfundon Salihu.

"Punëtorët nuk janë numra, janë jetë", Sindikata e Re e KEK-ut me aksion simbolik para zyrave të KEK-ut



PRISHTINË, 25 GUSHT - Sindikata e Re e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) ka zhvilluar të martën një aksion simbolik para zyrave të KEK-ut në Prishtinë, duke shprehur pakënaqësinë e saj lidhur me mënyrën e menaxhimit dhe trajtimit të punëtorëve. Me pankarta në duar "Punëtorët nuk janë numra,

janë jetë" dhe "Stop menaxhimit represiv", përfaqësuesit e sindikatës kanë kërkuar më shumë respekt për punëtorët dhe përmirësimin e kushteve në vendin e punës. Ditë më parë dy punëtorë të KEK-ut kanë ndërruar jetë në vendin e punës. Tashmë i ndjeri Arbenit

Ahmeti ka vdekur gjatë kryerjes së detyrave të punës, pasi ra në kontakt me tensionin elektrik. Edhe Haxhi (Selatin) Gojnovci, ka ndërruar jetë në Divizionin e Prodhimit të Qymyrit të KEK-ut gjatë kryerjes së detyrave të punës dhe derisa po lëvizte në zonën e ekskavatorit, pësoi aksidentin fatal.

PËRPLASJA GIORGIA MELONI – DONALD TRUMP: NJË PARALAJMËRIM PËR LIDERËT E EUROPËS

Giorgia Meloni besoi se afërsia ideologjike me Donald Trump do t'i siguronte Italisë një marrëdhënie të privilegjuar me SHBA. Përplasja mes tyre tregon kufijtë e aleancave ideologjike në epokën e “America First”

Nga Amy KAZMIN

Përvoja e Giorgia Meloni është shndërruar në një histori paralajmëruese për liderët europianë që tundohen të besojnë se afërsia ideologjike me Donald Trumpin u siguron mbrojtje politike.

Dikur një prej aleateve europiane më të vendosura të presidentit amerikan, kryeministrja italiane ka mësuar se mbrojtja e interesave kombëtare të vendit të saj nuk përputhet gjithmonë me vizionin agresiv të MAGA-s, të bazuar tek parimi “Amerika e para”.

Kur Roma refuzoi t'i lejonte ushtrisë amerikane përdorimin e bazave italiane për bombardimet e saj jopopullore ndaj Iranit, Trump iu kthye kundër një lidereje që më parë e kishte cilësuar si një “grua fantastike”, e cila e kishte “marrë Europën përpara si një stuh”.

Përplasja shumë shpejt u bë personale. Trump u ankua se Meloni “i mungonte guximi” dhe e akuzoi se i ishte “përgjyruar” për një fotografi me të gjatë samitit të G7-s në Francë, për të përmirësuar pozicionin e vet në sondazhe. Ajo iu përgjigj se fakti që ishte “mikja juaj” nuk e kishte ndihmuar aspak popullaritetin e saj, duke ndezur një luftë fjalësh nga e cila marrëdhëniet dikur miqësore mes tyre vështirë se do të rikuperohen.

“Koncepti ‘Amerika e para’ duhet të jetë një sinjal alarmi për një partner të huaj”, thotë Stefano Stefanini, ish-ambasador i Italisë në NATO. “Nuk mund të presësh shumë solidaritet nga një filozofi e tillë.”

Beniamino Irdi, ish-këshilltar i qeverisë italiane për politikën e jashtme, thotë se Meloni gaboi kur besoi se një botëkuptim i përbashkët nacionalist dhe konservator do t'i mundësonte të “kultivonte një marrëdhënie të veçantë” me presidentin amerikan. “Natyra transaksionale e Trumpit është e tillë që afërsia ideologjike të çon vetëm deri në një pikë”, thotë Irdi, tashmë bashkëpunëtor i lartë në German Marshall Fund. “Duhet të jesh realisht në gjendje të vendosësh diçka konkrete në tryezë.”

Giorgia Meloni, Nga e preferuara e MAGA-s tek kufijtë e pushtetit

Kur ishte një udhëheqëse e zjartrë euroskeptike e opozitës, Meloni ishte një prej të preferuarave të MAGA-s. Ajo vlerësohej për

sulmet ndaj Brukselit, emigracionit të parregullt dhe asaj që e quante “ideologjia woke”, e cila, sipas saj, kërcënonte identitetin e Italisë.

Por pasi mori pushtetin, ajo u përball me kufijtë e kësaj afërsie. Trump dhe rrethi i tij nuk arritën të kuptonin kufizimet politike dhe institucionale brenda të cilave ajo duhej të vepronte – nga opinioni publik armiqësor deri te roli i presidentit italian Sergio Mattarella në mbikëqyrjen e sigurisë kombëtare gjatë krizave, siç ishte sulmi amerikan ndaj Iranit.

“Ata nuk e kuptuan fare idenë se ajo nuk mund të bëjë çfarë të dojë – se vepron brenda një sërë kufizimesh”, thotë Giovanni Orsina, politolog në Universitetin Luiss të Romës. “Trump... nuk arriti të respektojë interesin kombëtar të Italisë. Internacionalja nacionaliste është një oksimoron.”

Pas rikthimit të Trumpit në Shtëpinë e Bardhë në vitin 2025, Meloni – e vetmja udhëheqëse e BE-së e pranishme në inaugurimin e tij – u përpoq ta paraqiste veten si ura e Europës drejt Uashingtonit, me shpresën se kjo do t'i forconte pozitën si në Bruksel, ashtu edhe në vend.

Në vend të kësaj, në sytë e shumë votuesve italianë, imazhi i Meloni është dëmtuar nga lidhja e saj e ngushtë me një president amerikan jopopullor. Trump ka vendosur tarifa të larta ndaj importeve nga BE-ja, u ka bërë presion aleatëve të NATO-s që të rrisin ndjeshëm shpenzimet e mbrojtjes dhe ka sulmuar Iranin – politika që kanë dëmtuar rëndë interesat italiane.

“Afërsia e saj me Trumpin nuk i ka sjellë asnjë rezultat të dukshëm”, thotë Riccardo Alcaro, drejtor kërkimor në Institutin e Çështjeve Ndërkombëtare në Romë, duke e quajtur miqësinë e saj të dikurshme me Trumpin një “albatros elektoral”, ndërsa Meloni përgatitet për një fushatë të vështirë rizgjedhjeje.

Si u ndërtua lidhja e Meloni me republikanët

Afrimi i Meloni me Partinë Republikane, përfshirë figurat kryesore të MAGA-s, nisi më shumë se një dekadë më parë, kur ajo ishte ende një figurë periferike e opozitës dhe përpigjeje të distanconte veten – dhe partinë e saj të re, Fratelli d'Italia – nga rrënjët neofashiste. Ajo po përpigjeje të ndëronte një identitet të ri si konservatore kombëtare e rrymës kryesore: pjesë e një



familjeje politike globale të respektueshme dhe jo një relike e së djathtës ekstreme italiane të pasluftës.

Ndërsa ishte në opozitë, Meloni u ftua dy herë të fliste në Conservative Political Action Conference (CPAC), takimin e përvitshëm politik të republikanëve. Ndërkohë, ideologu i MAGA-s Steve Bannon u shfaq si folës kryesor në festivalin politik Atreju të partisë së saj në vitin 2018. “Ajo e kupton shumë mirë se politika ka një dimension shumë të fortë transnacional”, thotë Orsina, duke shtuar se MAGA fillimisht i dha Meloni “një shtëpi, një ideologji dhe një markë”.

Por, si kryeministre, pragmatizmi i kujdesshëm i Meloni ka zhgënjyer puristët më radikalë të MAGA-s, si Bannon, i cili u tha mediave italiane se ajo kishte tradhtuar “bindjet e saj themelore”.

Meloni ka kombinuar masa të ashpra për frenimin e emigracionit të parregullt me rritjen e kuotave për emigrantët e ligjshëm. Ajo gjithashtu e ka zbutur retorikën e saj kundër BE-së. “Nuk mund të qëndrosh pranë një lëvizjeje që dëshiron të shkatërrojë unitetin e Europës”, thotë një konsulent politik me lidhje të afërta me Fratelli d'Italia. “Ky nuk mund të jetë objektivi i një partie konservatore në Itali. Objektivi është ta ndryshosh BE-në, jo ta shkatërrosh atë.”

Giorgia Meloni, ekuilibri i vështirë me Trumpin

Fillimisht, Meloni krijoi marrëdhënie të ngrohta me administratën e dytë Trump, duke ruajtur për më shumë se një vit

një ekuilibër delikat.

Ajo kundërshtoi hakmarrjen e BE-së ndaj tarifave të Trumpit, heshti për afrimin e tij me presidentin rus Vladimir Putin në kuriz të Ukrainës dhe shmangu kritikën ndaj kërcënimit të tij për të marrë Groenlandën.

Edhe pasi Trump bombardoi Iranin, duke shkaktuar një spirale rritjeje të çmimeve globale të energjisë, Meloni nuk pranoi as t'i dënonte, as t'i mbështeste sulmet, duke thënë se nuk kishte informacionin që kishte çuar në ndërmarrjen e tyre.

Por Mario Sechi, ish-zëdhënës i qeverisë Meloni, thotë se vendimi i njëanshëm i Uashingtonit për të sulmuar pa u konsultuar me aleatë të prekur drejtpërdrejt, si Italia, i tensionoi seriozisht marrëdhëniet. “Nëse do aleatë, duhet të flasësh me aleatët”, thotë Sechi. “Ky është problemi me Shtëpinë e Bardhë... Kjo, sipas meje, ishte origjina e largimit.”

Përplasja që e bëri konfliktin personal

Sulmi i Trumpit ndaj Papa Leonit XIV, pasi ky i fundit dënoi luftën në Iran, i la Meloni pak mundësi tjetër përveçse të reagonte. “Heshtja nuk ishte një opsion për asnjë kryeministër italian, e aq më pak për një që e ka ndërtuar identitetin e saj politik si një grua e krishterë dhe katolike”, thotë Alcaro.

Kritika e saj e matur me shkrim zemëroi një president që tashmë ishte i irrituar nga mungesa e mbështetjes europiane për fushatën e tij në Iran. “Në sytë e Trumpit, ishte lëse-majesté”, thotë Alcaro. “Ajo nuk tregoi nënshtrimin që, sipas tij, vartësit ia detyrojnë shefit.”

Roma tani po përpigjeje të frenojë një përçarje që konsiderohet kryesisht “personale”. Pasi Trump bëri thirrje për një “urdhër kufizues” ndaj Meloni përpara samitit të fundit të NATO-s, Roma deklaroi se nuk do t'u përgjigjej më provokimeve të tij. Zyrtarët italianë këmbëngulin se marrëdhëniet dypalëshe mbeten të forta dhe Meloni e ministrat e saj po forcojnë lidhjet me figura të tjera të administratës, përfshirë Sekretarin e Shtetit Marco Rubio. “Administrata Trump dhe kabineti i Meloni po flasin mes tyre, kjo është e sigurt”, thotë Sechi.

Mësimi për Europën: ideologjia nuk mjafton

Por analistët thonë se vështirësitë e Meloni me Shtëpinë e Bardhë nuk pasqyrojnë vetëm personalitetin e Trumpit, por edhe një botëkuptim të MAGA-s që duket se pret një nënshtrim pothuajse të plotë nga aleatët.

“Është e vështirë të thuhet nëse paaftësia për të punuar me partnerët është karakteristike e lëvizjes MAGA apo diçka te Trumpi që e bën këtë të pamundur”, thotë Stefanini. “Lëvizja MAGA është kaq e përqendruar tek vetvetja dhe kaq izolacioniste, saqë vetë koncepti i bashkëpunimit dhe ndarjes së përgjegjësisë i është i huaj.”

Irdi thotë se antagonizmi i rrënjësor thellë i MAGA-s ndaj BE-së si projekt politik e bën gjithashtu të vështirë për çdo udhëheqës me një vizion paneuropian që të ruajë për një kohë të gjatë marrëdhëniet tepër të afërta me administratën. / Financial Times – Bota.al

RESORTI NË SHQIPËR, DEMOKRATËT NË SHBA ZGJEROJNË HETIMIN NDAJ DHËNDRIT TË DONALD TRUMP



Demokratët në Komisionin e Drejtësisë të Dhomës së Përfaqësuesve po zgjerojnë hetimin e tyre ndaj Jared Kushnerit, dhëndrit të presidentit Donald Trump dhe të dërguarit të tij për paqen në Gaza, për të shqyrtuar edhe një resort luksoz që ai dëshiron të ndërtojë në bregdetin shqiptar – një projekt që ka shkaktuar protesta prej javësh dhe akuza se toka mbi të cilën do ndërtohet është siguruar përmes një akti pronësie të falsifikuar.

Në një letër të siguruar fillimisht nga MS NOW, deputeti Jamie Raskin nga Marylandi, demokrati më i lartë në Komisionin e Drejtësisë të Dhomës së Përfaqësuesve, tha se ka pyetje të reja lidhur me “praktikat e dyshimta të pasurive të paluajtshme” të Kushnerit dhe kërkon që ai të dorëzojë dokumente që lidhen me “miratimin ose shqyrtimin” e projekteve të tij në Shqipëri, përfshirë çdo komunikim me qeverinë amerikane dhe atë shqiptare.

Raskin tha se demokratët duan të përcaktojnë nëse “veprimet e Kushnerit duhet të hetohen sipas Ligjit për Praktikën e Korrupsionit Jashtë Vendlindjes” dhe nëse ky ligj ka nevojë për përditësim. Sipas një përmbledhjeje të Departamentit të Tregtisë, ligji e bën “të paligjshme që një person ose kompani amerikane t’i ofrojë, paguajë ose premtojë t’i paguajë para ose çdo gjë tjetër me vlerë një zyrtari të huaj, me qëllim

marrjen ose ruajtjen e një biznesi”.

Letra e përshkallëzon një hetim që Raskin e nisi në prill ndaj asaj që demokratët e quajtën “konfliktin e dukshëm dhe të pakorrigjueshëm të interesit” të Kushnerit: të shërbejë njëkohësisht si i dërguar i Shtëpisë së Bardhë për paqen dhe si drejtues i një firme të kapitalit privat, e cila mbështetet pjesërisht nga fondet sovraane të pasurisë së vendeve të Gjirit. Edhe ky hetim ishte raportuar fillimisht nga MS NOW.

“Ndërsa vepronit si kryenegociatori i vendit tonë për t’i dhënë fund disa konflikteve ndërkombëtare të krijuara ose përkeqësuar nga administrata e vjehrrit tuaj, ju gjetët kohë të nisnit një incident ndërkombëtar krejtësisht më vete,” shkroi Raskin në letrën e re lidhur me përpjekjet e Kushnerit në Shqipëri.

Përfaqësuesit e Kushnerit në firmën e tij të investimeve nuk iu përgjigjën menjëherë kërkesave për koment.

Zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë, Anna Kelly, e cilësoi kërkesën e Raskinit si pjesë të “të njëjtës narrative të lodhur që demokratët kanë përdorur kundër presidentit Trump, familjes së tij dhe administratës së tij prej një dekade”.

“Veprimtaritë personale të biznesit të Jared Kushnerit nuk kanë të bëjnë fare me angazhimet e tij diplomatike, të cilat ai i kryen vullnetarisht me kërkesë të presidentit,” vazhdoi

Kelly, duke vënë në dukje atë që ajo e përshkroi si “rekordin e suksesit” të Kushnerit në Marrëveshjet e Abrahamit dhe nisma të tjera.

Kushner njoftoi planet për zhvillimin e një resorti në bregdetin shqiptar në vitin 2024, si pjesë e një investimi nga firma e tij Affinity Partners. Por projekti ka shkaktuar protesta gjatë muajve të fundit, përfshirë edhe në kryeqytetin e Shqipërisë, të nxitura nga zemërimi lidhur me raportimet për sjellje të dhunshme të rojeve të sigurisë në kantier dhe shqetësimet për ndikimin e mundshëm mbi faunën, përfshirë flamingot, fokat dhe breshkat e detit.

Projekti shkaktoi polemika të tjera në korrik, kur u publikuan raportime se një biznesmen — i kërkuar në Shqipëri për pastrim parash dhe për rolin e dyshuar në një operacion ndërkombëtar të kontrabandës së drogës — kishte falsifikuar aktin e pronësisë së tokës ku do të ndërtohet resorti. Biznesmeni mohoi çdo shkelje. Wall Street Journal raportoi se banorët e fshatit ishin përpjekur ta paralajmëronin Kushnerin se toka ishte vjedhur.

Një zëdhënës i grupit të zhvillimit të mbështetur nga Kushner tha për Journal se sistemi ligjor shqiptar është “vendi i përshtatshëm për zgjidhjen e çështjeve mbi pronësinë e tokës”, por këmbënguli se “blerjet e tokave në fjalë janë kryer në mënyrë të ligjshme”.

Në letrën drejtuar Kushnerit, Raskin shkroi se i gjithë “episodi

pasqyron si joseriozitetin tuaj thelbësor si ish-përfaqësues i Shteteve të Bashkuara, ashtu edhe oreksin mbizotërues dhe në dukje të pangopur të familjes Trump-Kushner për korrupsion politik dhe financiar”.

Ai shtoi: “Qeveria e kryeministrit shqiptar Edi Rama, e cila prej kohësh ka kërkuar të ndikojë në politikën amerikane, ju dha miratimin, por kryeministri nuk mundi të fitonte miratimin e vetë elektoratit të tij për projektin tuaj të ëndrrave.”

Kushneri, i cili është i martuar me vajzën e madhe të Trumpit, Ivanka, themeloi firmën e investimeve Affinity Partners në vitin 2021, pasi shërbeu si këshilltar i lartë gjatë administratës së parë të Trumpit. Sipas The New York Times, investitori më i madh dhe i parë i Affinity ishte Fondi i Investimeve Publike i Arabisë Saudite, i drejtuar nga Princi i Kurorës Mohammed bin Salman, i cili investoi rreth 2 miliardë dollarë. Kanë investuar gjithashtu fonde sovraane të pasurisë të lidhura me Katarin dhe Emiratet e Bashkuara Arabe.


Që kur Trump u rikthye në Shtëpinë e Bardhë vitin e kaluar, Kushner ka punuar si i dërguar i SHBA-së për paqen, duke marrë pjesë në bisedime për t’i dhënë fund konflikteve jashtë vendit, përfshirë konfliktin me Iranin. Në letrën e tij të re, Raskin vuri në dukje se Kushner nuk i ishte përgjigjur kërkesës fillestare të komisionit, e cila kërkonte komunikimet e tij me zyrtarë

sauditë, emiratet, katariotë ose izraelitë, si dhe dokumente financiare që detajonin investitorët e Affinity.

“Për t’ju dhënë përfitimin e dyshimit,” shkroi Raskin, “supozoj se mund të keni qenë shumë i shpërqendruar dhe i devijuar nga përpjekjet tuaja të përsëritura dhe të dështuara për të negociuar një armëpushim të qëndrueshëm në Iran, Liban ose Ukrainë, saqë nuk patët mundësi të përgjigjeshtit.”

Ekipi i Kushnerit i ka kundërshtuar akuzat për shkelje. Në prill, shefi i departamentit ligjor të Affinity i tha MS NOW se Kushner ka vepruar “në përputhje me të gjitha ligjet dhe kërkesat në fuqi dhe gjithmonë në interesin më të mirë të Shteteve të Bashkuara”. Një zëdhënës i Shtëpisë së Bardhë tha në atë kohë se Kushner kishte “sakrifikuar kohë me familjen dhe mjetet e tij të jetesës” për të punuar në nismat e administratës.

Si pjesëtarë të pakicës në Dhomën e Përfaqësuesve, demokratët nuk kanë kompetenca për të lëshuar fletëthirrje dhe kanë aftësi të kufizuara për ta detyruar Kushnerin të bashkëpunojë. Kjo do të ndryshonte nëse ata fitojnë kontrollin e Dhomës në nëntor. Demokratët e kanë bërë tashmë të qartë se kanë një listë të gjerë objektivash për hetime nëse rimarrin kontrollin e njëres ose të të dyja dhomave të Kongresit — dhe në këtë listë përfshihet edhe Kushneri. (MS Now)



Kristjan Asllani kërkohet nga Al-Jazira FC

MILAN, 25 GUSHT - Kristjan Asllani duket gjithnjë e më pranë largimit nga Interi, ndërsa destinacioni i ardhshëm i mesfushorit shqiptar mund të jetë Emiratet e Bashkuara Arabe.

Eksperti italian i merkatos, Gianluca Di Marzio, ka raportuar se Al-Jazira FC ka shfaqur interesim për 24-vjeçarin dhe ka kërkuar informacione për një transferim të mundshëm.

Sipas raportimeve, klubi nga Emiratet tashmë ka nisur negociatat me Interin dhe transferimi mund të realizohet, nëse palët arrijnë marrëveshje. Megjithatë, mbetet për t'u parë vendimi

i vetë Asllanit, i cili së fundmi ka refuzuar disa oferta. Mesfushori shqiptar, i cili është pjesë e Interit, sezonin e kaluar e kaloi në huazim te Torino dhe Beshiktashi.



DONJETA SADIKU SIGURON MEDALJEN E PARË PËR KOSOVËN NË "TARANTO 2026"

TARANTO, 25 GUSHT - Boksierja Donjeta Sadiku ia ka siguruar Kosovës medaljen e parë në Lojërat Mesdhetare "Taranto 2026", pasi ka triumfuar në çerekfinale ndaj turkes Esmanur Lok. Sadiku ka fituar me vendim të ndarë të gjyqtarëve, 4:1, në kategorinë deri në 60 kilogramë, pas një dueli të fortë dhe të luftuar deri në fund.

Ajo e ka nisur më mirë përballjen dhe dominoi në raundin e parë, ndërsa Lok reagoi në të dytin. Në raundin vendimtar pati shumë shkëmbime goditjesh, por Sadiku ishte më e saktë dhe ka realizuar goditjet më të pastra. Përvoja dhe qetësia e boksieres nga Kosova kanë rezultuar vendimtare, pavarësisht se kundërshtarja turke kishte avantazh në gjatësi. Me kalimin në gjysmëfinale, Sadiku ka siguruar të paktën medaljen e bronzte, ndërsa synimi i saj mbetet medalja e artë. Në gjysmëfinale, ajo do të përball

let me greken Sofia Legaki, me objektivin për të siguruar finalen. Në kategorinë deri në 60 kilogramë garojnë vetëm gjashtë boksierë. Sadiku është tashmë e vetmja përfaqësuese e Kosovës në boks që vazhdon garimin në "Taranto 2026", pasi katër boksierët e tjerë nga Kosova janë eliminuar në luftërat e para. Me medaljen e parë të siguruar, Sadiku tashmë do të kërkojë që suksesin e Kosovës ta shndërrojë në medalje të artë.



KOSOVA MPOSHTET NGA EGJIPTI NË HENDBOLL

TARANTO, 25 GUSHT - Hendbollistët e Kosovës kanë pësuar edhe humbjen e dytë në Lojërat Mesdhetare "Taranto 2026". Kosova është mposhtur nga Egjipti me rezultat të thellë 42:21, në një ndeshje ku skuadra egjiptiane, e cilësuar si një nga favoritët e turneut, ka dominuar sidomos në pjesën e dytë. Hendbollistët

e Kosovës kanë arritur të qëndronin afër kundërshtarit deri në fund të pjesës së parë, e cila ka përfunduar 17:14 në favor të Egjiptit. Megjithatë, në pjesën e dytë Egjipti ka rritur ndjeshëm ritmin dhe ka dominuar plotësisht, duke shënuar 25 gola, ndërsa Kosova ka realizuar vetëm shtatë. Në paraqitjen e saj,

Kosova ka pasur probleme me realizimin, duke humbur shumë raste dhe duke bërë disa gabime teknike. Kjo ishte humbja e dytë e Kosovës në turne. Të dielën, përfaqësuesja e Kosovës ishte mposhtur nga Italia me rezultat 39:23. Ndeshjen e radhës Kosova do ta zhvillojë të enjten ndaj Portugalisë.



HANA BEIQI E 13-A NË KUALIFIKIMET E 50 METRAVE STIL I LIRË NË "TARANTO 2026"



TARANTO, 25 GUSHT - Notarja më e mirë e Kosovës, Hana Beiqi është renditur e 13-a në kualifikimet e disiplinës 50 metra stil i lirë në Lojërat Mesdhetare "Taranto 2026". Beiqi e ka përfunduar garën me kohën 26 sekonda e 72 të qindtat, ndërsa në këtë disiplinë kanë garuar gjithsej 22 notare. Për të siguruar një

vend në finale nevojitej koha 25 sekonda e 89 të qindtat, me tetë notaret më të shpejta që kanë kaluar tutje. Në të njëjtën disiplinë ka garuar edhe Riga Shala, e cila ka përfunduar garën në vendin e fundit me kohën 28 sekonda e 11 të qindtat. Në 50 metra stil i lirë të meshkujt ka garuar edhe Dior

Krasniqi. Ai është renditur i 18-i dhe i fundit nga notarët që kanë startuar, me kohën 24 sekonda e 97 të qindtat. Notari i parafundit kishte kohën 23 sekonda e 93 të qindtat, ndërsa koha e fundit që ka siguruar finalen ishte 22 sekonda e 73 të qindtat. Ndërkohë, në disiplinën 100 metra shpinë ka garuar Erina

Idrizaj, e cila është renditur e nënta nga 11 notare. Idrizaj ka përfunduar garën me kohën 1 minutë, 8 sekonda e 56 të qindtat, ndërsa notarja e tetë, e cila ka siguruar kualifikimin në finale, kishte kohën 1 minutë, 4 sekonda e 33 të qindtat. Idrizaj ka arritur të lërë pas notare nga Libani dhe Shqipëria.

Jasir Asani hyn në historinë e futbollit iranian

TEHERAN, 25 GUSHT - Jasir Asani ka hyrë në historinë e futbollit iranian me Esteghlal, duke shënuar golin e 1100-të të klubit në të gjitha garat. Skuadra ku aktivizohet edhe futbollisti i Kombëtares shqiptare e ka arritur këtë

shifër historike në ndeshjen ndaj Sepahanit, ku ishte pikërisht Asani ai që ka zhbllokuar rezultatin. Me këtë gol, Esteghlal ka vendosur një rekord të veçantë, pasi është bërë klubi i parë në futbollin iranian që ka kaluar shifrën e

1100 golave. Për Asanin, sfida ndaj Sepahanit ishte e veçantë edhe për një arsye tjetër. Sulmuesi shqiptar ka arritur në kuotën e 100 golave të shënuar në karrierën e tij me klube. Pas këtyre arritjeve, Esteghlal i ka kushtuar një

dedikim Asanit në rrjetet sociale, duke vlerësuar kontributin e tij dhe rëndësinë që ka fituar në skuadër. Asani është një prej futbollistëve kryesorë të Esteghlalit, që aktualisht po kryeson kampionatin iranian.



VENDIM

-

ODLUKU

- 

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë


facebook

www.facebook.com/gjeipuneshpejte

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjmnazit "Hajdar Duishi" Gjakovë.



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

